



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



BASHKIA TIRANË

TIRANA BUSINESS UNIVERSITY

Nr. 106 prot.

Tiranë, më 22.10.24

Nr. 38974 prot.

Tiranë, më 22.10.24

## MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

PËR

## PRAKTIKËN MËSIMORE DHE PROFESIONALE

Sot, më datë 22.10.2024 lidhet kjo marrëveshje bashkëpunimi midis palëve:

1. Bashkisë Tiranë, me adresë Bulevardi "Dëshmorët e Kombit" nr. 1, 10001, Tiranë, përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Tiranë, Z. Erion Veliaj, quajtur këtu e në vijim si "Bashkia";

dhe

2. Tirana Business University, me adresë "Rezervat e Shtetit", Rr. Rezervat e Shtetit, Lundër, Tiranë, përfaqësuar nga Z. Altin Sholla, quajtur këtu e në vijim si "Universiteti";

Të quajtura bashkarisht ose veçmas si "Palët".

Duke qenë se:

Palët kanë shprehur vullnetin për ngritjen e urave të bashkëpunimit midis tyre për mundësimin e angazhimeve të përbashkëta në studime, trajnime, seminare, konferenca, procese të vlerësimit të

shërbimeve, standarteve dhe kapaciteteve në ofrimin e shërbimeve, praktikave mësimore, si dhe në hartimin e politikave të reja sociale, programeve dhe projekteve të shërbimeve për grupe dhe komunitete në nevojë, palët bien dakort të nënshkruajnë këtë marrëveshje bashkëpunimi me kushte si më poshtë vijon:

## **Neni 1 Qëllimi**

Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është përcaktimi i rregullave të bashkëpunimit dhe njohja e ndërsjelltë, ngritja dhe zhvillimi i mëtejshëm i njohurive profesionale dhe akademike, ngritja e kapaciteteve të stafit dhe studentëve si dhe shkëmbimi i praktikave më të mira në fushat me itneres të përbashkët midis palëve.

## **Neni 2 Objekti**

1. Objekti i kësaj marrëveshjeje është bashkëpunimi midis palëve në lidhje me kryerjen e praktikave mësimore pranë Bashkisë Tiranë për studentët e Universitetit.
2. Marrëveshja synon bashkëpunimin midis palëve në drejtim të shkëmbimit të eksperiencave dhe realizimin e projekteve të përbashkëta.

## **Neni 3 Baza ligjore**

Kjo marrëveshje bazohet në:

- a) ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë" (i ndryshuar);
- b) ligjin 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" (i ndryshuar);
- c) ligjin nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë";
- ç) ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" (i ndryshuar);
- d) "Rregulloren mbi kryerjen e praktikës në Bashkinë Tiranë" miratuar me Vendimin nr. 34362/1 datë 6.10.2022 të Kryetarit të Bashkisë.

## **Neni 4 Angazhimet e palëve**

1. Palët marrin përsipër të bashkëpunojnë bazuar në frymën e një mirëkuptimi reciprok dhe vullneti pozitiv për të siguruar kushtet e nevojshme për realizimin e angazhimit dhe iniciativave të ndërmarra nga palët.
2. Universiteti merr përsipër të udhëzojë studentët e angazhuar në studime pranë Universitetit mbi kryerjen e praktikës në Bashkinë Tiranë.
3. Bashkia merr përsipër të zbatojë procedurat e parashikuara nga rregullorja "Mbi kryerjen e praktikës në Bashkinë Tiranë" për ofrimin e praktikave mësimore për studentët e Universitetit.

4. Në lidhje me përmbledhjen, përpunimin apo transferimin e të dhënave personale gjatë zbatimit të angazhimeve të parashikuara nga kjo marrëveshje, palët marrin përsipër të përmbushin të gjitha detyrimet që burojnë nga kuadri ligjor në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

#### **Neni 5 Personi i kontaktit**

1. Personat e kontaktit do të jenë përgjegjës për zbatimin e kësaj marrëveshjeje, me qëllim realizimin e objektivave duke komunikuar dhe shkëmbyer të dhënat në mënyrë sa më korrekte dhe efektive.
2. Personat e kontaktit për secilën palë, në kuadër të implementimit të kësaj marrëveshjeje janë:

Për Bashkinë Tiranë:  
Znj. Marsida Thartori  
Email: [marsida.thartori@tirana.al](mailto:marsida.thartori@tirana.al)  
Tel: 0693360305

Për Universitetin:  
Z. Samel Kruja  
Email: [samel.kruja@tbu.edu.al](mailto:samel.kruja@tbu.edu.al)  
Tel: 0699604111

3. Në rast të ndryshimit të njërës prej këtyre personave, pala e cila përfaqësohet prej këtij personi duhet të njoftojë me shkrim palën tjetër nënshkruese brenda një jave kalendarike për të dhënat e personit të ri të kontaktit.

#### **Neni 6 Kohëzgjatja**

1. Kjo marrëveshje lidhet për një afat 2 vjeçar duke filluar nga data e nënshkrimit të saj, me të drejtë rinovimi, me dakordësinë paraprake të palëve.
2. Çdonjëra nga palët mund të kërkojë të zgjidhë marrëveshjen duke lajmëruar palën tjetër me shkrim të paktën një muaj përpara datës së zgjidhjes.

#### **Neni 7 Mosmarrëveshjet**

Çdo mosmarrëveshje, keqkuptim apo keqinterpretim në realizimin e kësaj marrëveshjeje do të zgjidhet me mirëkuptim midis palëve, në frymën e bashkëpunimit, tolerancës dhe kuadrit të etikës morale.

#### **Neni 8 Dispozita kalimtare**

1. Palët janë të detyruara të respektojnë këtë marrëveshje bashkëpunimi për të gjithë kohëzgjatjen e parashikuar në Nenin 6.
2. Marrëveshja mund të ndryshohet vetëm nëpërmjet një marrëveshje me shkrim të nënshkruar nga të dyja palët.
3. Kjo marrëveshje përpilohet në 4 (katër) kopje, nga të cilat 2 (dy) mbahen nga Bashkia dhe 2 (dy) mbahen nga Universiteti.
3. Kushtet e kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi pranohen dhe nënshkruhen nga të dyja palët.


### Palët nënshkruese

PËR

TIRANA BUSINESS UNIVERSITY

ADMINISTRATOR

Z. ALTIN SHOLLA



PËR

BASHKINË TIRANË

KRYETAR I BASHKISË TIRANË

Z. ERION VELIAJ

